

201908901156

AGJENCIA TEKNIKE - OPERATIVE

Në bazë të nenit 6 dhe nenit 11 paragrafit (3) të Ligjit për Agjencinë Teknike-Operative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/18), drejtori i Agjencisë Teknike-Operative Shkupi miratoi:

RREGULLORE PËR FORMËN DHE PAMJEN E LEGJITIMACIONIT DHE DISTINKTIVIT ZYRTAR TË PERSONAVE ZYRTARË TË AUTORIZUAR NË AGJENCINË TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP DHE MËNYRA E LËSHIMIT, E PËRDORIMIT DHE E EVIDENTIMIT TË TYRE

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton formën dhe pamjen e legjitimacionit dhe distinktivit zyrtar të lëshuar për punëtorët e Agjencisë Teknike-Operative Shkup me status të zyrtarit të autorizuar (në tekstin e mëtejme: PZA), si dhe mënyrën e lëshimit, të përdorimit dhe të evidentimit të tyre.

Neni 2

(1) Legjitimacioni zyrtar i punonjësit të Agjencisë Teknike-Operative Shkup (në tekstin e mëtejme: ATO) me status PZA është bërë në letër të bardhë, e plastifikuar në foli me përmasa 6,5x9,5 cm. (në tekstin e mëtejme: legjitimacioni zyrtar), i cili ndodhet në pjesën e sipërme të brendshme të një mbulese lëkure të zezë dypjesëshe me përmasa 8x23 cm.

(2) Ana e përparme e kartës së legjitimacionit zyrtar ka pamjen e mëposhtme në pozicion vertikal:

1) Në pjesën e sipërme, në mes është vendosur stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nën të cilën shkruhet teksti: “REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT”, dhe poshtë saj: “AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP”;

2) Në pjesën qendrore të faqes së përparme të legjitimacionit zyrtar është vendosur fotografia e PZA-së, me përmasa 2,5 x 3 cm., sipër së cilës ka mbishkrimin: “LEGJITIMACIONI ZYRTAR” dhe numrin e serisë së saj, dhe emri dhe mbiemri shkruhet poshtë fotografisë së PZA-së në ATO dhe poshtë tyre mbishkrimi: “PERSON ZYRTAR i AUTORIZUAR”;

3) Në këndin e poshtëm djathtas është vendi për nënshkrimin e drejtorit të ATO-së.

(3) Ana e pasme e legjitimacionit zyrtar ka pamjen e mëposhtme në pozicion vertikal:

1) Logoja e ATO-së është e printuar në pjesën e sipërme të anës së pasme;

2) Në pjesën e mesme të anës së pasme, në mes shkruhet teksti i mëposhtëm: “TË DHËNA PËR PERSONIN ZYRTAR TË AUTORIZUAR:” nën të cilin shënohen të dhënat e mëposhtme të PZA-së:

- numri i amzës;

- adresa e vendbanimit;

- grupi i gjakut.

3) Në pjesën e poshtme të anës së pasme, shkruhen të dhënat për legjitimacionin zyrtar, përkatësisht:

- numri i regjistrimit të legjitimacionit zyrtar;

- data e lëshimit.

(4) Legjitimacioni zyrtar i përshkruar në këtë nen lëshohet në formularin, i cili është dhënë në aneksin 1, i cili është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 3

(1) Në pjesën e brendshme të poshtme të mbulesës prej lëkure dypjesëshe, në pjesën e mesme qendrore, është ngjitur një distinktiv metalik në formë të rrumbullakët, me diametër 6 cm, në ngjyrë argjendi dhe të zezë (më tej: distinktiv), me pamjen e mëposhtme:

1) Në pjesën e sipërme të distinktit, në gjysmërreth, në sfond të argjendtë me shkronja të zeza shkruhet: “AGJENCIA TEKNIKE - OPERATIVE SHKUP”, dhe në pjesën e poshtme, në sfond të argjendtë me shkronja të zeza në gjysmërreth shkruhet: “REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT”.

2) Në pjesën qendrore të distinktit, në sfond të zi me shkronja dhe shenja të hirta, ndodhet logoja e ATO-së, në pjesën e poshtme të së cilës shkruhet numri serik i distinktit në sfond të hirtë me numra të zinj, i cili është i njëjtë me numrin serik të legjitimacionit zyrtar.

(2) Pamja e distinktit është dhënë në shtojcën 2, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 4

(1) Në anën e sipërme të jashtme të mbulesës prej lëkure dypjesëshe, në pjesën qendrore në vetë lëkurën ka një stampë në formë të rrumbullakët, me diametër 5 cm, ku në pjesën e sipërme të stampës, në gjysmërreth shkruhet: “AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP”, dhe në pjesën e poshtme, në gjysmërreth, shkruhet: “REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT”, ndërsa në pjesën qendrore të stampës është logoja OTA.

(2) Pamja e stampës nga paragrafi (1) i këtij neni është dhënë në shtojcën 3, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 5

(1) Legjitimacioni dhe distinktivi zyrtar i lëshohen punonjësit në ATO, i cili është i punësuar në një pozicion që në aktin për sistemimin e vendeve të punës në ATO është përcaktuar me status PZA.

(2) Me rastin e lidhjes së një marrëdhënie pune në një vend pune me status PZA, drejtori i ATO-së i lëshon ato dhe Njësia e Sigurisë e ATO-së ia dorëzon legjitimacionin zyrtar dhe distinktivin PZA, i cili me legjitimacionin zyrtar dhe distinktivin, obligohet personalisht të nënshkruajë reversin e lëshuar nga ATO-së.

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të reversit nga paragrafi (2) i këtij neni e përcakton drejtori i ATO-së dhe është dhënë në shtojcën 4, që është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 6

(1) Legjitimacioni zyrtar dhe distinktivi janë të vlefshme për sa kohë personi të cilit i është lëshuar ka kapacitetin zyrtar të PZA-së në ATO.

(2) Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës ose kapacitetit të PZA-së në ATO, PZA-ja është i detyruar t’ia kthejë legjitimacionin dhe distinktivin zyrtar Njesisë së Sigurisë së ATO-së brenda 1 (një) dite.

(3) Nëse personi nuk vepron sipas paragrafit (2) të këtij neni, drejtori e shpall legjitimacionin zyrtar dhe distinktivin si të pavlefshëm.

Neni 7

Gjatë një periudhe kohore të mungesës në punë prej 30 (tridhjetë) ditësh ose më shumë, drejtori i ATO-së mund t’i kërkojë PZA-së të deponojë legjitimacionin zyrtar dhe distinktivin për ruajtje në Njësinë e Sigurisë pranë ATO-së, dhe PZA nga Njësia e Sigurisë pranë ATO-së do të vendosë ta shënojë në

evidencën përkatëse nga neni 12 i kësaj Rregulloreje arsyen e deponimit, datën e deponimit dhe datën e kthimit të legjitimacionit dhe distinktivit zyrtar.

Neni 8

(1) PZA në ATO, i cili humb kartën e tij zyrtare të legjitimacionit dhe distinktivin ose përndryshe mbetet pa to maksimumi brenda 24 orëve, njofton drejtorin e ATO-së, mbikëqyrësin e tij të menjëhershëm dhe drejtuesin e Njesisë së Sigurisë pranë ATO-së, ku dorëzon një deklaratë të nënshkruar me dorë të vet, ku tregohet koha, vendi dhe rrethanat në të cilat legjitimacioni dhe distinktivi zyrtar janë humbur ose janë zhdukur në një mënyrë tjetër.

(2) Në rastin nga paragrafi (1), këtij anëtar të PZA-së i lëshohet legjitimacioni dhe distinktivi zyrtar i ri, ndërsa legjitimacioni dhe distinktivi zyrtar i lëshuar më parë shpallen të pavlefshme.

(3) Shpenzimet për bërjen e legjitimacionit dhe distinktivit të ri zyrtar i bart personi që i ka humbur ato.

Neni 9

Legjitimacioni dhe distinktivi zyrtar zëvendësohen me të reja, kur për shkak të dëmtimit ose konsumimit bëhen të papërdorshme ose kur mbajtësi të cilit i janë lëshuar ndryshon të dhënat personale, ndërsa PZA-ja duhet të kthejë legjitimacionin dhe distinktivin e vjetër zyrtar të cilat më pastaj asgjësohen.

Neni 10

Legjitimacioni zyrtar dhe distinktivët që merren ose zëvendësohen asgjësohen. Asgjësimi i legjitimacionit dhe i distinktivit zyrtar bëhet nga një komision prej tre anëtarësh nga radhët e punonjësve të ATO-së, i krijuar nga drejtori i ATO-së.

Neni 11

PZA-ja duhet të përdor legjitimacionin dhe distinktivin zyrtar vetëm për qëllime zyrtare, pra vetëm gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave zyrtare të përcaktuara në Udhëzimet për përdorimin e legjitimacionit dhe distinktivit zyrtar të ATO-së.

Neni 12

(1) Për legjitimacionet dhe distinktivët e lëshuar, të zëvendësuar ose të konfiskuar evidentohen në Njësinë e Sigurisë pranë ATO-së.

(2) Procesverbali nga paragrafi (1) i këtij neni përmban: numrin rendor (regjistrin), emrin dhe mbiemrin e personit të cilit i është lëshuar legjitimacioni dhe distinktivi, datën e lëshimit, numrin rendor dhe kolonën për vërejtje. Numri serik nga procesverbali në të cilin janë futur të dhënat shënohet në legjitimacioni zyrtar si numër regjistrimi.

Neni 13

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(2) Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së vlefturi Rregullorja për formën dhe pamjen e legjitimacionit dhe distinktivit zyrtar të personave zyrtarë të autorizuar në Agjencinë Teknike-Operative Shkup dhe mënyrën e lëshimit së saj, me numër 9.2-64/1 të datës 30.11.2018.

Numri 09.2-256/1
25 prill 2019
Shkup



Drejtor,
Zoran Angellovski, d.v.

Shtojca nr. 1


Rregullorja për formën dhe pamjen e legjitimacionit dhe distinktit zyrtar të personave zyrtarë të autorizuar në Agjencinë Teknike-Operative Shkup dhe mënyrën e lëshimit, të përdorimit dhe të evidentimit të tyre.

Pamja e legjitimacionit zyrtar:

Ana e përparme

| |
|---|
|  REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT AGJENCIA OPERATIVE-TEKNIKE SHKUP LEGJITIMACION ZYRTAR NR: XXX  EMRI DHE MBIEMRI PERSON ZYRTAR I AUTORIZUAR Drejtor: _____ |
|---|


ana e pasme

| |
|---|
|  TË DHËNA MBI PERSONIN ZYRTAR TË AUTORIZUAR: Nr. i amëz: _____ Adresa e banimit: _____ Grupi i gjakut: _____ Numri i regjistrimit i legjitimacionit zyrtar: _____ Data e lëshimit: _____ |
|---|

Shtojca nr. 2

Rregullorja për formën dhe pamjen e legjitimacionit dhe distinktit zyrtar të personave zyrtarë të autorizuar në Agjencinë Teknikë-Operative Shkup dhe mënyrën e lëshimit, të përdorimit dhe të evidentimit të tyre.

Pamja e distinktit:



Shtojca nr. 3

Rregullorja për formën dhe pamjen e legjitimacionit dhe distinktit zyrtar të personave zyrtarë të autorizuar në Agjencinë Teknike-Operativo Shkup dhe mënyrën e lëshimit, të përdorimit dhe të evidentimit të tyre.

Pamja e stampës në pjesën e jashtme të mbulesës së lëkurës:



Shtojca nr. 4

Rregullorja për formën dhe pamjen e legjitimacionit dhe distinktitit zyrtar të personave zyrtarë të autorizuar në Agjencinë Teknike-Operativo Shkup dhe mënyrën e lëshimit, të përdorimit dhe të evidentimit të tyre.

Numri _____
më _____, _____, _____

REVERS

për

pranimdorëzimin e legjitimacionit dhe distinktitit zyrtar të PZA pranë ATO-së

AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE Shkup (ATO), me datë _____, punonjës në ATO në pozitën _____, me status të PZA-së, lëshon legjitimacionin dhe distinktitin zyrtar të mëposhtëm:

- Numri serik i legjitimacionit dhe distinktitit zyrtar _____;
- Numri i regjistrimit të legjitimacionit zyrtar _____;
- Data e lëshimit të legjitimacionit dhe distinktitit zyrtar _____.

Duke nënshkruar këtë Revers, punonjësi me status të PZA-së deklaron dhe konfirmon:

- 1) se ka marrë legjitimacionin zyrtar dhe distinktitin, dhe
- 2) se ai njeh dhe pranon kushtet për përdorimin e legjitimacionit dhe distinktitivëve zyrtarë të parashikuar në Udhëzimet e vlefshme për përdorimin e legjitimacionit zyrtar dhe distinktitivëve të PZA-së pranë ATO-së dhe se nuk do t'i keqpërdorë ato për qëllime private, dhe për çdo vërejtje të parregullsive do t'i njoftojë menjëherë drejtorin e ATO-së dhe Udhëheqësin e Njesisë së Sigurisë pranë ATO-s.

Dorëzoi:
Udhëheqësi i Njesisë së Sigurisë
Emri dhe mbiemri
Nënshkrimi:

Pranoi:
PZA:
Emri dhe mbiemri _____
Nënshkrimi: _____

Data e pranimdorëzimit: _____